



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 06.05.2025  
Numër Protokolli: 3047/2025

A.nr.409/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.409/2025 të datës 03.03.2025 të parashtruar nga ankuesja Z.R, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*Transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Detyrohet** Administratori në Gjykatën Themelore në Gjilan, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 09.10.2024 që ndërlidhet me kërkesën e ankueses.

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile Z.R (*tutje referuar vetëm* ankuesja), më datë 26.02.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është pranuar me datë 03.03.2025 me numër protokolli 1384/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me mos informimin dhe mos marrjen e përgjigjes lidhur me kërkesën për transferim të përhershëm në vend tjetër të punës brenda institucionit konkretisht pozitën Zyrtar i Personelit, e njëjta kërkon anulimin e shpalljes publike për pozitën Zyrtar i Personelit në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe të obligohet Sekretariati të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të trajtojë kërkesën për transferim të përhershëm e cila kërkesë ka aprovimin nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe pas

trajtimin të nxjerrë vendimin për transferim të përhershëm si e drejtë e cila buron nga marrëdhënia e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 27.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1384/2025 të datës 03.03.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për transferim të përhershëm në vend tjetër të punës brenda institucionit konkretisht në pozitën Zyrtar i Personelit; E-mail nga S.Q. për B.G. i datës 30.01.2025; Kërkesë për anulim të konkursit vetëm sa i përket pozitës Zyrtar i Personelit të shpallur me datë 05.02.2025 në faqen e KGJK-së; Pliko me numër R6704836 i datës 26.02.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 14.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 27.03.2025; Akt Emërim i Z.R. me numër protokolli 03-1311 i datës 01.07.2024; E-mail nga Z.R. për B.G. etj. i datës 06.10.2020; E-mail nga B.G. për Sh.M. i datës 31.01.2025; E-mail nga B.G. për S.Q. i datës 15.10.2024; E-mail nga Z.R. për S.Q. etj. i datës 09.10.2024; E-mail nga Z.R. për B.G. etj. i datës 13.02.2025; Konkurs i Jashtëm i SKGJK me numër nr. 01/2025 i datës 05.02.2025; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 2518/2025 i datës 16.04.2025;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesja është e punësuar në pozitën ‘*Zyrtar Ligjor*’ në Departamentin Zyra për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Ankuesja me datë 09.10.2024 ka parashtruar kërkesë për transferim të përhershëm në vend tjetër të punës brenda institucionit konkretisht në pozitën Zyrtar i Personelit tek U.d. Administratori i Gjykatës Themelore në Gjilan. Me datë 15.10.2024 Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore ka kthyer përgjigje te Administratori i Gjykatës duke theksuar se kërkohet pajtimi i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë. Ndërsa U.d. Administratori i Gjykatës Themelore në Gjilan përmes e-mailit të datës 30.01.2025 ka njoftuar Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore të SKGJK si në vijim citoj: *Në lidhje me kërkesën për transferim të paraqitur nga znj. Z.R ju njoftoj se në konsulltim edhe me kryetarin e Gjykatës Themelore Gjilan z. V.S. jemi dakord për këtë transferim. Për këtë arsye ju lutem mund të vazhdoni me procedurat e nevojshme sipas rregulloreve në fuqi.*

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me mos informimin dhe mos marrjen e përgjigjes lidhur me kërkesën për transferim të përhershëm në vend tjetër të punës brenda institucionit konkretisht pozitën Zyrtar i Personelit, e njëjta kërkon anulimin e shpalljes publike për pozitën Zyrtar i Personelit në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe të obligohet Sekretariati të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të trajtojë kërkesën për transferim të përhershëm e cila kërkesë ka aprovimin nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe pas trajtimit të nxjerrë vendimin për transferim të përhershëm si e drejtë e cila buron nga marrëdhënia e punës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se meqë pala ankuese më datë 09.10.2024 ka parashtruar kërkesë për transferim të përhershëm në vend tjetër të punës brenda institucionit konkretisht në pozitën Zyrtar i Personelit tek U.d. Administratori i Gjykatës Themelore në Gjilan, atëherë lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën dhe të nxjerr aktin administrativ, ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *“3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar; përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar”*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”*, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”*, organi të cilit i është drejtuar kërkesa është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative. Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtroj ankesë tek organi i shkallës më të lartë për heshtje administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj kërkesës së ankuses, ankesa e saj e datës 03.03.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar kuadrit ligjor të përmendur si më lartë dhe lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, obligon organin përkatës të punësimit gjegjësisht Administratorin në Gjykatën Themelore në Gjilan, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 09.10.2024 të parashtruar nga ankuesja, dhe në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohet të gjitha pretendimet e palës ankuese dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se gjatë shqyrtimit të kërkesës së datë 09.10.2024 së palës ankuese, duhet të shqyrtohet fakti nëse kërkesa plotëson kushtet ligjore lidhur me parashkrimin në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.409/2025**

**Çlirim Zeka**

Procesmbajtës

**Eshref Shabani**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses Z.R;
- Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Administratorit në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.